



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE SHËRBIMEVE**  
**MBËSHTETËSE**  
**DREJTORIA E FINANCES BUXHETIT DHE KONTABILITETIT**

Nr. 12325 prot.

Vlorë, më 19. 6 2026

**PROJEKTVENDIM**  
Nr. \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKB NR.100, DT.23.12.2025  
PËR BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2026”**

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_\_, 2026 pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga grupi i punës për hartimin e Buxhetit Shtesë të Bashkisë Vlorë për vitin 2026, mbështetur në:

Ligji nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8 pika 2, 9 pika 1.1.b, 34, 35, 36, 37, 39, 40, 41, 54 pika dh, dhe neni 64 pika c; Ligji nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuarLigjit 115/2014 datë 31.07.2014 “Për Ndarjen Administrative Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, neni 65.Udhëzimi i MFE nr.9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 28.02.2025 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028”Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (plotësues) nr.19 datë 10.07.2025 “Për përgatitjen e programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2026-2028”

Akti Normativ nr.11.19.12.2025 “Per transferten e pakushtezuar te pergjithshme “ per vitin 2025”V.K.B Nr. 98, datë 27.11.2025 “Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksionet e deleguara -2026”. V.K.B Nr. 96, datë 07.12.2023 “Për miratimin e sistemit të taksave tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024” i ndryshuar, shprehur i ligjshëm nga Prefekti i Qarkut Vlorë, me shkresën nr. 1038/1 prot., datë 12.12.2023. V.K.B nr.100 datë 23.12.2025 Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2026”.

**VENDOSI:**

1. Ndryshime në zërin investime të miratuara në VKB nr 100 datë 23.12.2025 i ndryshuar.

Për nevoja të Bashkisë për sa më poshtë :

<b>Pakesime</b>			
	<b>Bashkia Vlore Programi( 06260 ) artikulli 231 Investime</b>	000/mije leke	2026
1	Rikonstruksioni i palestres se shkolles "4 Heronjte"	-16,639	-16,639
	<b>Totali I Pakesimit</b>	<b>-16,639</b>	<b>-16,639</b>
<b>Shtesa</b>			
	<b>Bashkia Vlore Programi( 01110 ) artikulli 231 Investime</b>	000/mije leke	2026
1	Rikonceptimi I hapësirave publike në hyrje të rrugës :Donika Kastrioti	3,059	3,059
2	Blerje projekti për "Rehabilitimin e rrugës Dush Strati dhe ndertim te rruges se re "	8,580	8,580
	<b>Shuma I</b>	<b>11,639</b>	<b>11,639</b>
	<b>Bashkia Vlore Programi( 04570 ) artikulli 603 Subvencion</b>	000/mije leke	
1	Subvencioni I biletës së transportit urban	5,000	5,000
	<b>Shuma II</b>	<b>5,000</b>	<b>5,000</b>
	<b>Totali I paksim(I + II)</b>	<b>16,639</b>	<b>16,639</b>

Shoqëria e transportit publik urban “Urban Trans Vlora” e cila operon në qytetin e Vlorës prej vitit \_2017, në bazë të kontratës Nr 1382/20.02.2027 për një periudhë 10 vjeçare që ka lidhur me Bashkinë Vlorë si dhe me Vendimin e Këshillit Bashkiak 38-28.04.2022 është përcaktuar që vlera e biletës do të jetë 40 lekë e cila është zbatuar deri tani. Duke parë kushtet ekonomike nga vitet 2022 e deri tani, të cilat kanë ndryshuar si dhe ecurinë e kompanisë Urban Trans Vlora Shpk kërkojmë të subvencionohet nga Bashkia Vlorë vlera e biletës prej 7.3 lekë.

Argumenti për këtë ndryshim bazohet në inflacionin e viteve 2022-2025 si më poshtë:

<b>Periudha</b>	<b>Inflacioni bazë mesatar</b>
Maj 2022 – Dhjetor 2022	7,8%
Janar 2023 – Dhjetor 2023	5,3%
Janar 2024 – Dhjetor 2024	2,5%
Janar 2025 – Dhjetor 2025	2,7%
-----	
<b>Total</b>	<b>18.3%</b>

Vlera e biletës e miratuar 40 lekë \* 18.3 % = 7.3 lekë

Administrata e Bashkisë duke analizuar pasqyrat financiare të 3 viteve të fundit 2023, 2024, 2025, rezultuan këto tregues:

Vitet

2023	Humbje	(5.605.676) lekë
2024	Fitim	2.063.648 lekë
2025	Humbje	(724.731) lekë

Numri I biletave të shitura:

Vitet

2023	1.089.589	copë
2024	1.520.000	copë
2025	1.500.000	copë

Mesatarja e 3 viteve 1.369.863

Vlera për subvencion  $1.369.863 * 7.3 \text{ lekë} = 10.000.000$  për 1 vit kalendarik.

Për vitet 2026 do të subvencionohet për periudhën 1 Korrik -31 Dhjetor.

Vlera e subvencionit për 6-mujorin është  $10.000.000 / 2 = 5.000.000$  lekë.

### Objekti:

Rikonceptim i hapësirës publike në hyrje të rrugës “Donika Kastrioti”

### PREVENTIV

NR	KOD I	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSI A	SASI A	ÇMIMI	VLEFTA
		<b>1. PRISHJE</b>				
1	2.426/3	Prishje shtresa betoni >	m3	34	11,496.13	390,868.45
		<b>Shuma 1:</b>				<b>390,868.45</b>
		<b>2. PRODHIMI I MATERIALEVE TE NDERTIMIT</b>				
		Pergatitje hekur betoni i periodik Ø > 12 mm2 >				
2	1.88/p		kg	1200	129.84	155,811.60
3	1.31/p	Beton C-25/30 (Me zall) >	m3	17	10,383.48	176,519.14
4	1.19/p	Prodhim çakell per betone ( granil ) >	m3	34	2,340.80	79,587.27
		<b>Shuma 2:</b>				<b>411,918.01</b>
		<b>3. PUNIME DHEU</b>				
		Germim dheu me krah e transport k dore 10m,kat III >				
5	2.1		m3	68	2,208.89	150,204.52
		Germim e mbushje dheu me krah per kanale kategori III, h=1.5m >				
6	2.15		m3	20.2	2,268.59	45,825.52
		Germim dheu themele e plinta me b>2m, ekskavator me goma 0.25m3,shkarkimi ne toke >				
7	2.25		m3	13.8	222.16	3,065.81

		Hedhje, mbushje ngjeshje dheu të gërmuar, në kanal, tokë e butë (Hedhje humus për lulishtet) >				
8	2.19		m3	33.6	955.2	32,094.59
		Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km >				
9	2.37/5b		m3	102	467.28	47,662.56
		<b>Shuma 3:</b>				<b>278,852.99</b>
		<b>4. PUNIME SKELE DHE KALLEPI</b>				
		Kallep themele e mure me derrasa te veçuara >				
10	3.305		m2	57	1,602.51	91,342.96
		<b>Shuma 4:</b>				<b>91,342.96</b>
		<b>5. NENSHTRESA DHE SHTRESA NE TERRITORIN E NDERTESAVE</b>				
		Trotuar me lluster çimento, pa borduren e betonit >				
11	2.289		m2	95	2,200.41	209,039.05
		Bordura trotuari 25x12cm derdhur ne vend >				
12	2.291		ml	76.4	1,458.46	111,426.65
		Trotuar me pllaka, pa borduren e betonit >				
13	2.288		m2	25	3,475.40	86,884.97
		<b>Shuma 5:</b>				<b>407,350.67</b>
		<b>6. TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA</b>				
		F.V. Shtylla metalike per ndriçim, H=7m, d=160mm >				
14	3.169		copë	4	23,484.28	93,937.14
		<b>Shuma 6:</b>				<b>93,937.14</b>
		<b>7. LINJA T/L GERMIMI I GROPAVE TE SHTYLLAVE</b>				
		Germim dheu per gropa shtyllash T/L, ne toke mes kat III, ~ 1.5 m, sip tabani				
15	3.497/a	1.5m2 >	m3	4	3,044.69	12,178.75
		<b>Shuma 7:</b>				<b>12,178.75</b>
		<b>8. D. SINJALET DHE PAJISJET SHITESI. NGADALESUESIT E SHPEJTESISI</b>				
		F.V. Fidane bime kacavjerrese >				
16	3.963		copë	42	745.68	31,318.43
		F.V. Mbjellje peme dekorative Bli 16-18cm ne trotuar, (cdo 6m) >				
17	3.966		copë	10	16,704.15	167,041.46
		F.V. Fidane Lule dekorative >				
18	3.96		copë	42	226.97	9,532.53
		F.V. Fidane shkurre dekorative "Oleander" >				
19	3.962		copë	5	2,765.25	13,826.23
		F.V. Fidane Peme dekorative >				
20	3.961		copë	2	11,128.50	22,256.99
		<b>Shuma 8:</b>				<b>243,975.65</b>
		<b>9. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIME</b>				

21	3.392	F.V. Tuba plastmasi per vaditje, Ø42mm, pa sprucat >	m	30	253.18	7,595.31
<b>Shuma 9:</b>						<b>7,595.31</b>
<b>10. ANALIZA JASHTE LISTE</b>						
22	An	F.V Tapet bari >	m2	168	1,540.00	258,720.00
23	An	F.V Sprucator vaditje >	copë	4	2,149.00	8,596.00
24	An	F.V Panel komandimi vaditje >	copë	1	52,000.00	52,000.00
25	An	F.V Kosh mbeturinash, metalik, 26x94 cm, per ambient te jashtem >	copë	2	7,500.00	15,000.00
26	An	F.V Punime Elektrike >	copë	1	65,000.00	65,000.00
27	An	F.V Punime Hidraulike >	copë	1	55,000.00	55,000.00
28	An	F.V Punime MNZ >	copë	1	35,000.00	35,000.00
<b>Shuma 10:</b>						<b>489,316.00</b>
<b>Shuma Analiza</b>						<b>2,427,335.93</b>
<b>Fondi Rezervë (5.0%)</b>						<b>121,366.80</b>
<b>Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)</b>						<b>2,548,702.73</b>
<b>TVSH (20%)</b>						<b>509,740.55</b>
<b>Shuma me TVSH</b>						<b>3,058,443.27</b>
<b>Totali</b>						<b>3,058,443.27</b>

2. Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, autorizohet të bëjë ndarjen e fondeve të miratuara nga Këshilli i Bashkisë sipas strukturës buxhetore të miratuar nga Ministria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139/2015, datë 17.02.2015, neni 55, pika 6.

**KRYETAR**  
**Brunilda Mersini**

**ME URDHËR DHE DELEGIM**  
**NËNKRYETAR**

Joljana Llanaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE SHËRBIMEVE**  
**MBËSHTETËSE**  
**DREJTORIA E FINANCES BUXHETIT DHE KONTABILITETIT**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2026

**RELACION**

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKB NR.100, DT.23.12.2025  
PËR BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2026”**

**Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Vlorë**

Të nderuar Këshilltarë!

Ligji 9936/2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullon sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë, strukturën, parimet dhe bazat e procesit buxhetor, marrëdhëniet financiare ndërqeveritare dhe përgjegjësitë për zbatimin e legjislacionit buxhetor në tërësi. Ligji zbatohet nga njësitë e Qeverisjes Qëndrore dhe Vendore në të gjitha fazat e procesit buxhetor si përgatitja, shqyrtimi dhe miratimi në Këshill, zbatimi, ndjekja dhe rishikimi i buxhetit, të drejtat dhe kufizimet që përcakton ligji, garancitë, si dhe format e tjera të rrjedhura prej tyre, kontrolli, kontabiliteti, raportimi, inspektimi dhe auditimi i buxhetit.

Nga sa më lartë, Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe administrata nën drejtimin e tij, kanë hartuar projektvendimin “Për një shtesë në V.K.B nr.100, date 23.12.2025, bazuar në ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, nenet: 9 pika 1.1.b, 34, 35, 36, 37, 40, 41, 54 pika dh, dhe neni 64 pika c; Ligjin nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 45, Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit e buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 44, Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

1. Ndryshime në zërin investime të miratuara në VKB nr 100 datë 23.12.2025 i ndryshuar.  
Për nevoja të Bashkisë për sa më poshtë :

<i>Pakesime</i>			
	<b>Bashkia Vlore Programi( 06260 ) artikulli 231 Investime</b>	000/mije leke	2026
1	Rikonstruksioni i palestres se shkolles "4 Heronjte"	-16,639	-16,639
	<b>Totali I Pakesimit</b>	<b>-16,639</b>	<b>-16,639</b>
<i>Shtesa</i>			
	<b>Bashkia Vlore Programi( 01110 ) artikulli 231 Investime</b>	000/mije leke	2026
1	Rikonceptimi I hapësirave publike në hyrje të rrugës :Donika Kastrioti	3,059	3,059
2	Blerje projekti për "Rehabilitimin e rrugës Dush Strati dhe ndertim te rruges se re "	8,580	8,580
	Shuma I	11,639	11,639
	<b>Bashkia Vlore Programi( 04570 ) artikulli 603 Subvencion</b>	000/mije leke	
1	Subvencioni I biletës së transportit urban	5,000	5,000
	Shuma II	5,000	5,000
	<b>Totali I paksim(I + II)</b>	<b>16,639</b>	<b>16,639</b>

Pakësimi në investime me objekt “Rikonstruksioni i Palestrës së Shkollës "4 Heronjtë" në Shumën 16.639 mijë lekë pasi ne vitin 2025 u parashikua ne buxhetin vetem Palestra ,kurse ne fund te vitit 2025 projekti qe u be per rikonstruksionin e Shkolles 4 Heronjeve perfshin edhe palestren, ne keto kushte do te realizohet bashke me shkollen .

Shoqëria e transportit publik urban “Urban Trans Vlora” e cila operon në qytetin e Vlorës prej vitit \_2017, në bazë të kontratës Nr 1382/20.02.2027 për një periudhë 10 vjeçare që ka lidhur me Bashkinë Vlorë si dhe me Vendimin e Këshillit Bashkiak 38-28.04.2022 është përcaktuar që vlera e biletës do të jetë 40 lekë e cila është zbatuar deri tani. Duke parë kushtet ekonomike nga vitet 2022 e deri tani, të cilat kanë ndryshuar si dhe ecurinë e kompanisë Urban Trans Vlora Shpk kërkojmë të subvencionohet nga Bashkia Vlorë vlera e biletës prej 7.3 lekë.

Argumenti për këtë ndryshim bazohet në inflacionin e viteve 2022-2025 si më poshtë:

<b>Periudha</b>	<b>Inflacioni bazë mesatar</b>
Maj 2022 – Dhjetor 2022	7,8%
Janar 2023 – Dhjetor 2023	5,3%
Janar 2024 – Dhjetor 2024	2,5%
Janar 2025 – Dhjetor 2025	2,7%

-----  
Total 18.3%

Vlera e biletës e miratuar 40 lekë \* 18.3 % = 7.3 lekë

Administrata e Bashkisë duke analizuar pasqyrat financiare të 3 viteve të fundit 2023, 2024, 2025, rezultuan këto tregues:

Vitet

2023 Humbje (5.605.676) lekë  
2024 Fitim 2.063.648 lekë  
2025 Humbje (724.731) lekë

Numri I biletave të shitura:

Vitet

2023 1.089.589 copë  
2024 1.520.000 copë  
2025 1.500.000 copë

Mesatarja e 3 viteve 1.369.863

Vlera për subvencion 1.369.863 \* 7.3 lekë = 10.000.000 për 1 vit kalendarik.

Për vitet 2026 do të subvencionohet për periudhën 1 Korrik -31 Dhjetor.

Vlera e subvencionit për 6-mujorin është 10.000.000 /2 = 5.000.000 lekë.

### Objekti:

Rikonceptim i hapësirës publike në hyrje të rrugës “Donika Kastrioti”

### PREVENTIV

NR	KOD I	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSI A	SASI A	ÇMIMI	VLEFTA
		<b>1. PRISHJE</b>				
1	2.426/3	Prishje shtresa betoni >	m3	34	11,496.13	390,868.45
		<b>Shuma 1:</b>				<b>390,868.45</b>
		<b>2. PRODHIMI I MATERIALEVE TE NDERTIMIT</b>				
		Pergatitje hekur betoni i periodik Ø > 12 mm2 >				
2	1.88/p		kg	1200	129.84	155,811.60
3	1.31/p	Beton C-25/30 (Me zall) >	m3	17	10,383.48	176,519.14
4	1.19/p	Prodhim çakell per betone ( granil ) >	m3	34	2,340.80	79,587.27
		<b>Shuma 2:</b>				<b>411,918.01</b>
		<b>3. PUNIME DHEU</b>				
		Germim dheu me krah e transport k dore 10m,kat III >				
5	2.1		m3	68	2,208.89	150,204.52

6	2.15	Germim e mbushje dheu me krah per kanale kategori III, h=1.5m >	m3	20.2	2,268.59	45,825.52
7	2.25	Germim dheu themele e plinta me b>2m, ekskavator me goma 0.25m3,shkarkimi ne toke >	m3	13.8	222.16	3,065.81
8	2.19	Hedhje,mbushje ngjeshje dheu të gërmuar,në kanal,tokë e butë (Hedhje humus për lulishtet) >	m3	33.6	955.2	32,094.59
9	2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km >	m3	102	467.28	47,662.56
<b>Shuma 3:</b>						<b>278,852.99</b>
<b>4. PUNIME SKELE DHE KALLEPI</b>						
10	3.305	Kallep themele e mure me derrasa te veçuara >	m2	57	1,602.51	91,342.96
<b>Shuma 4:</b>						<b>91,342.96</b>
<b>5. NENSHTRESA DHE SHTRESA NE TERRITORIN E NDERTESAVE</b>						
11	2.289	Trotuar me lluster çimento, pa borduren e betonit >	m2	95	2,200.41	209,039.05
12	2.291	Bordura trotuari 25x12cm derdhur ne vend >	ml	76.4	1,458.46	111,426.65
13	2.288	Trotuar me pllaka, pa borduren e betonit >	m2	25	3,475.40	86,884.97
<b>Shuma 5:</b>						<b>407,350.67</b>
<b>6. TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA</b>						
14	3.169	F.V. Shtylla metalike per ndriçim, H=7m, d=160mm >	copë	4	23,484.28	93,937.14
<b>Shuma 6:</b>						<b>93,937.14</b>
<b>7. LINJA T/L GERMIMI I GROPAVE TE SHTYLLAVE</b>						
15	3.497/a	Germim dheu per gropa shtyllash T/L, ne toke mes kat III, ~ 1.5 m, sip tabani 1.5m2 >	m3	4	3,044.69	12,178.75
<b>Shuma 7:</b>						<b>12,178.75</b>
<b>8. D. SINJALET DHE PAJISJET SHITESI. NGADALESUESIT E SHPEJTESISË</b>						
16	3.963	F.V. Fidane bime kacavjerrese >	copë	42	745.68	31,318.43
17	3.966	F.V. Mbjellje peme dekorative Bli 16-18cm ne trotuar, (cdo 6m) >	copë	10	16,704.15	167,041.46
18	3.96	F.V. Fidane Lule dekorative >	copë	42	226.97	9,532.53
19	3.962	F.V. Fidane shkurre dekorative "Oleander" >	copë	5	2,765.25	13,826.23
20	3.961	F.V. Fidane Peme dekorative >	copë	2	11,128.50	22,256.99

		<b>Shuma 8:</b>				<b>243,975.65</b>
		<b>9. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIME</b>				
21	3.392	F.V. Tuba plastmasi per vaditje, Ø42mm, pa sprucat >	m	30	253.18	7,595.31
		<b>Shuma 9:</b>				<b>7,595.31</b>
		<b>10. ANALIZA JASHTE LISTE</b>				
22	An	F.V Tapet bari >	m2	168	1,540.00	258,720.00
23	An	F.V Sprucator vaditje >	copë	4	2,149.00	8,596.00
24	An	F.V Panel komandimi vaditje >	copë	1	52,000.00	52,000.00
25	An	F.V Kosh mbeturinash, metalik, 26x94 cm, per ambient te jashtem >	copë	2	7,500.00	15,000.00
26	An	F.V Punime Elektrike >	copë	1	65,000.00	65,000.00
27	An	F.V Punime Hidraulike >	copë	1	55,000.00	55,000.00
28	An	F.V Punime MNZ >	copë	1	35,000.00	35,000.00
		<b>Shuma 10:</b>				<b>489,316.00</b>
<b>Shuma Analiza</b>						<b>2,427,335.93</b>
<b>Fondi Rezervë (5.0%)</b>						<b>121,366.80</b>
<b>Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)</b>						<b>2,548,702.73</b>
<b>TVSH (20%)</b>						<b>509,740.55</b>
<b>Shuma me TVSH</b>						<b>3,058,443.27</b>
<b>Totali</b>						<b>3,058,443.27</b>

- Drejtorja e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, autorizohet të bëjë ndarjen e fondeve të miratuara nga Këshilli i Bashkisë sipas strukturës buxhetore të miratuar nga Ministria e Financës.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139/2015, datë 17.02.2015, neni 55, pika 6.

**DREJTOR**

**Hiqmet Haxhaj**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
DREJTORIA E URBANISTIKËS

Nr. 12325/ prot.

Vlorë, më 17.06.2026

## RELACION ARKITEKTONIK

Objekti: “Rikonceptim i hapësirës publike në hyrje të rrugës Donika Kastrioti”

Vendndodhja	Hyrja e rrugës “Donika Kastrioti”, Bashkia Vlorë
Investitor/Zhvillues	Bashkia Vlorë
Projektues	Drejtorja e Urbanistikës
Faza e projektit	Arkitekturë / rikualifikim hapësire publike
Data e projektit	17.06.2026
Vlera e preventivit	3,058,443.27 lekë, me TVSH

### 1. Hyrje

Ky relacion arkitektonik hartohet për objektin “Rikonceptim i hapësirës publike në hyrje të rrugës Donika Kastrioti”, me qëllim argumentimin teknik, urbanistik, arkitektonik dhe funksional të ndërhyrjes së propozuar nga Bashkia Vlorë.

Ndërhyrja parashikon rikualifikimin e një hapësire publike ekzistuese, e cila ndodhet në hyrje të rrugës “Donika Kastrioti”, në një pikë të dukshme urbane dhe me përdorim të përditshëm nga banorët, qytetarët dhe vizitorët. Në gjendjen aktuale, kjo hapësirë nuk e përmbush funksionin e saj publik, pasi është amortizuar, janë dëmtuar shtresat e trotuarit, gjelbërimi ekzistues është degraduar dhe hapësira është kthyer në mënyrë informale në parkim automjesh.

Projekti synon kthimin e kësaj hapësire në një mini-hapësirë të gjelbër urbane, me funksion qëndrimi, pritjeje, kalimi dhe çlodhjeje, duke përfshirë sistemimin e trotuarit, krijimin e sipërfaqeve të gjelbra, vendosjen e stolave, ndriçimit publik, koshave urbane dhe elementeve të tjera të mobilimit urban.

### 2. Gjendja ekzistuese

Nga verifikimi në terren dhe nga materialet fotografike të administruara rezulton se hapësira në hyrje të rrugës “Donika Kastrioti” paraqet një gjendje të amortizuar dhe jo të përshtatshme për përdorim publik cilësor.

Trotuari ekzistues është pjesërisht i dëmtuar dhe nuk krijon kushte të mira për lëvizjen e këmbësorëve. Në disa segmente sipërfaqet janë të prishura, të çrregullta dhe të papërshtatshme për përdorim të sigurt, veçanërisht për të moshuarit, fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara.

Gjelbërimi ekzistues është i dëmtuar dhe i pamirëmbajtur. Pemët e mbjella përgjatë trotuarit kanë pësuar dëmtime, ndërsa sipërfaqet përreth tyre nuk janë të sistemuara në mënyrë të rregullt. Hapësira nuk ka një koncept të qartë peizazhistik dhe nuk krijon një ambient të denjë për qëndrim apo pritje.

Një problematikë e evidentuar është përdorimi informal i hapësirës si parkim për automjete. Në zonë janë konstatuar automjete të parkuara në mënyrë të pakontrolluar, përfshirë edhe automjete që qëndrojnë për periudha të gjata pa lëvizur. Ky përdorim ka cenuar karakterin publik të hapësirës, ka penguar funksionimin normal të saj dhe është kthyer në shqetësim për qytetarët.

Në praktikë, kjo hapësirë është kthyer edhe në një vend pritjeje për qytetarët dhe vizitorët, përfshirë persona të huaj që presin për takime apo orientohen drejt zonës. Për këtë arsye, ndërhyrja nuk ka vetëm karakter estetik, por edhe funksional dhe social, pasi i përgjigjet një përdorimi real të krijuar nga vetë dinamika urbane e zonës.

### 3. Qëllimi i ndërhyrjes

Qëllimi i ndërhyrjes është rikonceptimi i hapësirës publike ekzistuese dhe kthimi i saj në një hapësirë të gjelbër, të sigurt, funksionale dhe të përdorshme nga komuniteti.

Ndërhyrja synon të përmirësojë cilësinë urbane të hyrjes së rrugës "Donika Kastrioti", të eliminojë përdorimin informal si parkim automjesh dhe të krijojë një ambient të përshtatshëm për qëndrim të shkurtër, pritje, kalim dhe çlodhje.

Përmes projektit synohet rehabilitimi i trotuarit ekzistues, rikthimi i funksionit publik të hapësirës, krijimi i një mini-hapësire të gjelbër urbane, përmirësimi i imazhit të hyrjes së rrugës, vendosja e stolave për qëndrim, përmirësimi i ndriçimit publik, vendosja e koshave urbane, rehabilitimi dhe pasurimi i gjelbërimit, kufizimi i parkimit informal dhe krijimi i një ambienti më të sigurt për qytetarët dhe vizitorët.

### 4. Koncepti arkitektonik dhe urban

Koncepti arkitektonik i ndërhyrjes mbështetet në krijimin e një hapësire të vogël publike, të organizuar qartë, ku bashkëvepron tre elementë kryesorë: gjelbërimi, kalimi i këmbësorëve dhe qëndrimi publik.

Projekti parashikon krijimin e një kompozimi të thjeshtë urban, ku hapësira qendrore trajtohet si zonë qëndrimi dhe gjelbërimi, ndërsa perimetri i saj lidhet me trotuarin dhe lëvizjen e këmbësorëve. Në qendër të kompozimit parashikohet një element rrethor i gjelbëruar, i cili krijon identitet vizual dhe organizon hapësirën përreth.

Rikonceptimi synon të krijojë një pikë urbane të qartë dhe të lexueshme në hyrje të rrugës, duke i dhënë kësaj hapësire një funksion të ri publik. Hapësira nuk trajtohet më si zonë e mbetur apo e përdorur për parkim, por si një mikro-lulishtë urbane, e integruar me rrugën, trotuarin dhe gjelbërimin përreth.

Elementet e propozuara, si stolat, ndriçimi, koshat dhe gjelbërimi, janë vendosur në mënyrë që të mos pengojnë lëvizjen e këmbësorëve dhe të krijojnë një hapësirë të përdorshme gjatë gjithë ditës.

### 5. Organizimi funksional i hapësirës

Organizimi funksional i hapësirës parashikon ndarjen e saj në zona përdorimi: zona e kalimit, zona e qëndrimit, zona e gjelbërimit dhe zona teknike e mirëmbajtjes.

Zona e kalimit siguron lëvizjen e këmbësorëve përgjatë trotuarit dhe lidhjen me rrugën kryesore. Kjo zonë duhet të jetë e lirë, e rregullt dhe pa pengesa.

Zona e qëndrimit pajiset me stola dhe ndriçim, duke krijuar mundësi për pritje të përkohshme, çlodhje dhe qëndrim të shkurtër nga qytetarët dhe vizitorët.

Zona e gjelbërimit përbën elementin kryesor të përmirësimit estetik dhe mjedisor të hapësirës. Kjo zonë trajtohet me tapet bari, pemë dekorative, shkurre dekorative, lule dhe bimësi të përshtatshme për klimën urbane të Vlorës.

Zona teknike e mirëmbajtjes përfshin sistemin e vaditjes, sprucatorët, tubacionet për ujitje dhe panelin e komandimit të vaditjes, me qëllim garantimin e jetëgjatësisë së gjelbërimit.

### 6. Ndërhyrjet ndërtimore dhe sistemuese

Punimet e propozuara përfshijnë fillimisht prishjen e shtresave ekzistuese të betonit, pastrimin e sipërfaqes dhe përgatitjen e terrenit për sistemimin e ri. Kjo fazë është e nevojshme për shkak të amortizimit të shtresave ekzistuese dhe gjendjes së dëmtuar të hapësirës.

Në vijim parashikohen punime dheu, gërmime, mbushje, ngjeshje dhe transport i materialeve, me qëllim krijimin e bazës së nevojshme për realizimin e trotuareve, sipërfaqeve të gjelbra dhe elementeve të reja urbane.

Projekti parashikon ndërtimin dhe riparimin e trotuarit me llustër çimento dhe me pllaka, si dhe vendosjen e bordurave të trotuarit të derdhura në vend. Këto elemente krijojnë kufizim të qartë të hapësirës, rregullojnë lëvizjen dhe ndajnë zonat e kalimit nga sipërfaqet e gjelbra.

Punimet në beton, përfshirë betonin C-25/30 dhe përgatitjen e hekurit të betonit, lidhen me realizimin e elementeve ndërtimore të qëndrueshme, përfshirë pjesët e sistemimit, kufizimet, bazamentet dhe elementet e nevojshme për formësimin e hapësirës.

Në tërësi, punimet ndërtimore kanë karakter rikualifikues dhe nuk synojnë krijimin e një objekti të ri ndërtimor volumor, por përmirësimin e një hapësire publike ekzistuese.

## 7. Trajtimi i trotuarit dhe lëvizja e këmbësorëve

Riparimi dhe rikonceptimi i trotuarit është një nga elementet kryesore të ndërhyrjes. Në gjendjen ekzistuese, trotuari është i dëmtuar dhe pjesërisht i zënë nga automjetet, duke mos ofruar kushte të mira për kalim.

Projekti parashikon trajtimin e sipërfaqeve të kalimit me materiale të përshtatshme për hapësira publike, me qëllim krijimin e një sipërfaqeje të rregullt, të qëndrueshme dhe të sigurt.

Bordurat e reja ndihmojnë në përcaktimin e kufijve të hapësirës dhe në mbrojtjen e sipërfaqeve të gjelbra nga ndërhyrjet e automjeteve. Në këtë mënyrë, projekti synon të disiplinojë përdorimin e hapësirës dhe të rikthejë prioritetin te këmbësorët.

Lëvizja e këmbësorëve duhet të mbetet e pandërprerë dhe e sigurt, ndërsa elementet e mobilimit urban dhe gjelbërimit duhet të vendosen pa krijuar pengesa në aksin kryesor të kalimit.

## 8. Gjelbërimi dhe peizazhi urban

Gjelbërimi përbën elementin më të rëndësishëm të rikonceptimit të hapësirës. Në vend të një sipërfaqeje të amortizuar dhe të përdorur për parkim, projekti parashikon krijimin e një mini-hapësire të gjelbër me funksion estetik, mjedisor dhe social.

Punimet e parashikuara përfshijnë vendosjen e tapetit të barit, mbjelljen e pemëve dekorative, fidaneve dekorative, bimëve kacavjerrëse, luleve dekorative dhe shkurreve dekorative të tipit "Oleander".

Parashikohet gjithashtu mbjellja e pemëve dekorative të tipit bli, me diametër 16-18 cm, të cilat kontribuojnë në krijimin e hijes, përmirësimin e mikroklimes dhe rritjen e cilësisë mjedisore të hapësirës.

Përdorimi i bimësisë dekorative synon krijimin e një imazhi të gjelbër, të mirëmbajtur dhe të qëndrueshëm, duke e kthyer këtë zonë në një pikë më të këndshme dhe më tërheqëse për banorët dhe vizitorët.

Për ruajtjen e gjelbërimit është parashikuar edhe sistem vaditjeje, me tuba plastmasi, sprucatorë dhe panel komandimi, në mënyrë që mirëmbajtja e hapësirës të jetë më efikase dhe më e kontrolluar.

## 9. Ndriçimi publik dhe siguria

Ndriçimi publik është pjesë e rëndësishme e projektit, pasi hapësira do të përdoret jo vetëm gjatë ditës, por edhe gjatë orëve të mbrëmjes. Vendosja e shtyllave metalike për ndriçim me lartësi 7 m krijon kushte më të mira sigurie dhe e bën hapësirën më të përdorshme.

Ndriçimi ndihmon në rritjen e sigurisë së qytetarëve, në parandalimin e përdorimeve të papërshtatshme dhe në krijimin e një imazhi më të mirë urban.

Elementet e ndriçimit duhet të vendosen në mënyrë që të ndriçojnë zonën e kalimit, zonën e qëndrimit dhe sipërfaqet kryesore të përdorimit publik, pa krijuar verbim apo ndotje vizuale.

Punimet elektrike duhet të realizohen sipas kushteve teknike dhe standardeve të sigurisë, duke garantuar funksionim të qëndrueshëm dhe mirëmbajtje të lehtë.

## 10. Mobilimi urban

Mobilimi urban i propozuar përfshin vendosjen e stolave, koshave metalikë dhe elementeve të tjera plotësuese që i japin hapësirës funksion përdorimi publik.

Stolat janë parashikuar si elemente qëndrimi për qytetarët, banorët dhe vizitorët. Duke qenë se hapësira përdoret aktualisht edhe si vend pritjeje, vendosja e stolave i jep asaj një funksion të qartë dhe të organizuar.

Koshat metalikë për ambient të jashtëm ndihmojnë në ruajtjen e pastërtisë dhe administrimin më të mirë të mbetjeve. Këta elementë duhet të vendosen në pozicione të përshtatshme, pranë zonave të qëndrimit dhe kalimit, pa penguar lëvizjen.

Mobilimi urban duhet të jetë rezistent ndaj kushteve atmosferike, i qëndrueshëm ndaj përdorimit publik dhe i thjeshtë për mirëmbajtje.

## 11. Masat për eliminimin e parkimit informal

Një nga qëllimet kryesore të ndërhyrjes është eliminimi i përdorimit informal të hapësirës si parkim automjeteve. Në gjendjen ekzistuese, parkimi i pakontrolluar ka dëmtuar funksionin publik të hapësirës dhe ka krijuar shqetësim për qytetarët.

Përmes riorganizimit të sipërfaqeve, vendosjes së bordurave, gjelbërimit, stolave dhe elementeve të mobilimit urban, hapësira merr një funksion të qartë publik dhe bëhet më e vështirë për t'u përdorur si parkim informal.

Pas përfundimit të punimeve, është e nevojshme që strukturat përgjegjëse të Bashkisë të monitorojnë përdorimin e hapësirës, me qëllim parandalimin e rikthimit të automjeteve në zonën e rikualifikuar.

## 12. Ndikimi urban, social dhe mjedisor

Nga pikëpamja urbane, projekti përmirëson imazhin e hyrjes së rrugës "Donika Kastrioti", duke e kthyer një hapësirë të amortizuar në një pikë të organizuar, të gjelbër dhe të përdorshme.

Nga pikëpamja sociale, projekti krijon një hapësirë qëndrimi dhe pritjeje për qytetarët, banorët dhe vizitorët, duke i dhënë një funksion real dhe të dobishëm një zone që aktualisht përdoret në mënyrë të pakontrolluar.

Nga pikëpamja mjedisore, shtimi i gjelbërimit, pemëve dekorative, luleve dhe tapetit të barit ndihmon në përmirësimin e mikroklimës urbane, krijimin e hijes, reduktimin e sipërfaqeve të forta dhe rritjen e cilësisë vizuale të hapësirës.

Nga pikëpamja e sigurisë, ndriçimi i ri dhe organizimi më i mirë i hapësirës kontribuojnë në rritjen e ndjenjës së sigurisë për përdoruesit.

## 13. Preventivi i punimeve

Referuar preventivit të hartuar nga Drejtoria e Urbanistikës, punimet për objektin "Rikonceptim i hapësirës publike në hyrje të rrugës Donika Kastrioti" përfshijnë këto kategori kryesore: punime prishjeje, prodhim dhe përgatitje materialesh ndërtimi, punime dheu, punime kallesi dhe betoni, shtresa dhe nënshtresa në territor, punime elektrike dhe ndriçim, gërmime për shtylla ndriçimi, punime gjelbërimi dhe mbjellje dekorative, sistem vaditjeje, vendosje tapeti bari, vendosje sprucatorësh dhe paneli komandimi vaditjeje, vendosje koshash metalikë, punime elektrike, hidraulike dhe masa MNZ.

Vlera totale e preventivit, përfshirë fondin rezervë dhe TVSH-në, është 3,058,443.27 lekë.

Ky fond përfshin ndërhyrjet e nevojshme për rikualifikimin e plotë të hapësirës, duke përfshirë si punimet ndërtimore dhe sistemuere, ashtu edhe gjelbërimin, ndriçimin, vaditjen dhe mobilimin urban.

## 14. Mirëmbajtja

Pas realizimit të ndërhyrjes, hapësira duhet të jetë objekt mirëmbajtjeje periodike nga strukturat përgjegjëse. Mirëmbajtja duhet të përfshijë pastrimin e përditshëm të hapësirës, kujdesin për gjelbërimin, kontrollin e sistemit të vaditjes, zëvendësimin e bimësisë së dëmtuar, kontrollin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit, mirëmbajtjen e stolave dhe koshave, kontrollin e moslejimit të parkimit informal dhe ndërhyrjet korrigjuese në rast dëmtimesh.

Mirëmbajtja është kusht i domosdoshëm për qëndrueshmërinë e investimit dhe ruajtjen e funksionit publik të hapësirës.

## 15. Konkluzion

Rikonceptimi i hapësirës publike në hyrje të rrugës "Donika Kastrioti" është një ndërhyrje e nevojshme dhe e justifikuar nga pikëpamja arkitektonike, urbane, funksionale dhe sociale.

Gjendja ekzistuese e hapësirës, e karakterizuar nga amortizimi i trotuarit, dëmtimi i gjelbërimit, parkimi informal i automjeteve dhe mungesa e një funksioni të qartë publik, e bën të domosdoshëm rikualifikimin e saj.

Projekti propozon kthimin e kësaj hapësire në një mini-hapësirë të gjelbër urbane, me stola, ndriçim, gjelbërim dekorativ, sistem vaditjeje, trotuare të sistemuara dhe mobilim urban, duke i dhënë zonës një funksion të qartë publik dhe duke përmirësuar cilësinë e jetës urbane.

Nga pikëpamja arkitektonike dhe urbanistike, ndërhyrja vlerësohet e përshtatshme, pasi nuk krijon zhvillim volumor, nuk ndryshon karakterin publik të hapësirës dhe synon përmirësimin e një zone ekzistuese të amortizuar.

Në përfundim, rekomandohet realizimi i ndërhyrjes, pasi projekti i përgjigjet një nevoje reale të komunitetit dhe kontribuon në përmirësimin e hapësirave publike të qytetit.

SHTOJCË: Foto të gjendjes ekzistuese

Fotografitë e mëposhtme pasqyrojnë gjendjen aktuale të hapësirës publike, përdorimin informal si parkim dhe nevojën për rikualifikim urban.



Foto 1 - Gjendja ekzistuese



Foto 2 - Gjendja ekzistuese



Foto 3 - Gjendja ekzistuese



Foto 4 - Gjendja ekzistuese

Punoi : Urb. Erlind Kapaj

DREJTOR  
Ingli Xhaferaj



**RIKONCEPTIM I HAPËSIRËS PUBLIKE NË HYRJE TË  
RRUGËS: DONIKA KASTRIOTI**

**RRUGA: "DONIKA KASTRIOTI" - VLORË - INVESTITOR: BASHKIA VLORË  
PROJEKTUES: DREJTORIA E URBANISTIKËS**





**EMERTIMI FLETES:  
GJENDJA EKZISTUJESE**

TITULLI PROJEKTI:

**RIKONCEPTIM I HAPËSIRËS PUBLIKE NË HYRJE TË RRUGËS: DONIKA KASTRATI**

MEMORANDUM E PROJEKTI: RINDA DONIKA KASTRATI - VIDE

FASA E PROJEKTI: ARHITEKTURA  
3D + FLETES


INSTITUCION: BASHKIMIA VLORE



GRUPI PROJEKTORES

DIREKTORIA E URBANIZIMIT

Shkalla:



EMERTIMI FLETES:  
**PLAN SISTEMIM**

TIDALI/IBRUVISTI) RIKONCEPTIM I HAPËSIRËS PUBLIKE NË HYRJË TË RRUGËS: DONIKA KASTRATI


EMERGJENJA E PROJEKTI: SHKALLA "KOMUNIKACIONIT" MARR

FAZA E PROJEKTI: PROJEKTUESI  
 "INTECH" "TECHNO"



QEVERIA SHQIPTARE  
 DHE TEMA E ORGANIZUES  
 REPARTI I INZHINIERI BASHKËPËRITË





EMERTIMI FLETES:  
**MASTERPLAN**

TITULLI I PROJEKTTIT: RIKONCEPTIMI I HAPËSIRËS PUBLIKE NË HYRJE TË RRUGËS DONIKA KASTRATI

SHENDEBIJA E TROJEKTTIT: PRËGJATA - BUSHVA KASËRATI V.1/2018

FAZA E PROJEKTTIT: IMPLANTACIONE

AFRIMET DOKUMENTARE

TRASHËGIMI



SHENDEBIJA E TROJEKTTIT: PRËGJATA - BUSHVA KASËRATI V.1/2018





ENERJIMI FLETES:  
**PAMJE 3-DIMENSIONALE**

TIULLI PROJEKTI: **RIKONCEPTIMI I HAPËSIRËS PUBLIKE NË HYRJE TË RRUGËS DONIKA KASTRATI**

VENKOPIMANT E PROJEKTI: **INJIDA - TËORJA KASHTIARË VLODE**

FAKTI E PROJEKTI: **AMBITENTIZIMI**


FAKTI E KLASIFIKIMI: **RI-KLASIFIKIMI**



GRUPI I PROJEKTI: **SHKURTORIA E VIKIMANISTIKES**

INJIDA - TËORJA KASHTIARË VLODE

Shkurtoria



EMERTIMI FLETES:  
**PAMJE 3-DIMENSIONALE**

THELLI PROJEKTI:

RIKONCEPTIMI I HAPËSIRËS PUBLIKE NË HYRJE TË RRUGËS: DONIKA KASTRATI

VËNDOSJA E PROJEKTI: RROGA - QORRIJA KASTRATI VJONË

FAZA E PROJEKTI: AMBULANCA  
TRAFIKETIS



ORGANIZIMI I PROJEKTI: DREKTOREJA E BASHKISIA VJONË

EMERTIMI I PROJEKTI:

Shkollë



EMERTIMI FLETES:  
**PAMJE 3-DIMENSIONALE**

Titulli i Projektit	RIKONCEPTIMI I HAPËSIRËS PUBLIKE NË HVREJË TË RRUGËS DOKIKA KASTRATI	Grupi i Projektit	SHKUR
Vendobësi dhe Projekti	SHKUR - TËRHEQJA AKADEMIKUT KALOR	Faza e Projektit	ARHITEKTURA PRAJËKTIMIT
		Titulli i Titullit	BAJRAMI KALOR
Organizimi dhe Lindja e Projektit			



FOTO ILUSTRUESE E STOLIT TË BETONIT

FOTO ILUSTRUESE E SHTYLLES SË NDRICIMIT




FOTO ILUSTRUESE E KOSHIT METALIK



EMERTIMI FLETES:  
FOTO REFERENCE

TRUULLI PROJEKTI

RIKONCEPTIMI I HAPËSIRËS PUBLIKE NË HYRJE TË RRUGËS DONIKA KASTRATI

VEPËRODHEJA E PROJEKTI: INZHIRA, TOPERA KASTRATI, V. GRI

Faza e projektit: ZAMONTIKESHA  
1991-1993




REALIZUESI: MARRAMASQOR

COGHI I RIVOLUCIONIT

DREJTORIA E URBANISTIKES

SHKALLI





EMERTIMI FLETES:  
**PANJË 3-DIMENSIONIALE**

TIPOLOGJIA E PROJEKTI	RIKONCEPTIMI I HAPËSRIRËS PUBLIKE NË HYRJE TË RRUOGËS, DOMIKA KASTRATI	GRUPE I PROJEKTOREVE	SHKËMBI
MBROHTJA E PROJEKTI	MBROHTJA E RRUOGËS KASTRATI NË QYTIN	ARCHITECTURA	DR. JONAN, E. HARRISHTI
FAZA E PROJEKTI	PROJEKTI	PROJEKTI	
MBROHTJA E PROJEKTI	MBROHTJA E RRUOGËS KASTRATI NË QYTIN	PROJEKTI	



EMERTIMI FLETES:  
**PAMJE 3-DIMENSIONALE**

TITULLI PROJEKTI	RIKONCEPTIMI I HARËSIRËS PUBLIKE NË HYRJE TË RRUGËS: DONIKA KASTRATI	ORIENTIMI I PROJEKTTIT	DIKIMI
VENDOSHASI E PROJEKTI - NRODA	TERRA MEDITERRANEA URBAN	ORGANIZIMI E BIRORAKSIVËSIA	
FAZA E PROJEKTI	TRAI I VITIT	SHËRITITË: BASHKËPËRQYJE	





FOTO ILUSTRUESE E STOLIT TË BETONIT

EMERTIMI FLETËS:  
FOTO REFERENCE

FOTO ILUSTRUESE E SHTYLLES SË NDRICIMIT




FOTO ILUSTRUESE E KOSHTIT METALIK



TITULLI PROJEKTI:

RIKONCEPTIMI I HAPËSIRËS PUBLIKE NË HYRJE TË RRUGËS: DONIKA KASTRATI

VETËDORËJA E PROJEKTIT: IRBANA - "IRBANA KASTRATI" V.GORË

FAZA E PROJEKTI: TËRËSI  
TËRËSI



DESIGNER: DARRIA VOGUE

OBJEKTI I PROJEKTIMIT:

OHREJONIA E URBANISHTKES

SHALLA